



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KÖRPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KÖRPORACIJA d.d.

I Nr. 461 Dt. 13/01/2012
~~RESKRIPTI~~

Për: Dr. Ali Hamiti
Kryesues i Zyrës së
Rregullatorit të Energjisë
1
Hamdi Mramori, Prishtinë
10000

Arben Gjokaj
Drejtor Menaxhues i KEK Sh.a.

Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Clinton
Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës
www.kek-energy.com

Ref e KEK-ut:

**METODA E DORËZIMIT:
PËRMES KORRIERIT dhe
EMAIL-it**

Ref juaj:
Data: 13.01.2012

TEMA: Aplikimi Tarifor i KEK Sh.a. për vitin 2012 – Dorëzimi i Pjesës V-të

I nderuari Profesor Hamiti,

Bashkëngjitur gjeni pjesën e pestë dhe të fundit të aplikimit tarifor të KEK-ut për vitin 2012. Ky është aplikimi për Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike (FPEE), i cili dokumenton dhe përmban rekomandimet për (1) kostot e Furnizuesit Publik, (2) përcaktimin e kostos për të gjithë të licensuarve që do të përfshihen në tarifën e rregulluar me pakicë, (3) metodologjinë për përcaktimin e kostove për t'u shërbyer kategorive të ndryshme të konsumatorëve në mënyrë që të caktohen tarifën kosto reflektive, dhe (4) mënyrën në të cilën rritja pasqyrohet në tarifë.

Kjo pjesë përdor informacione nga Pjesët I deri IV, të cilat janë dorëzuar së voni në ZRRë:

- Pjesa I, Informatat Bazë për të gjithë të Licensuarit, të cilat kanë dokumentuar Bazën e Aseteve të Rregulluara dhe Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit
- Pjesa II, Aplikimi Tarifor i Rregulluar për Gjenerator, lidhur me kostot e Kosovës A dhe B dhe minierave
- Pjesa III, Çmimi i Energjisë Elektrike me Shumicë, lidhur me çmimin e Energjisë me Shumicë, përfshirë gjenerimin, koston e importit, blerjet nga gjeneratorët e tjerë vendorë dhe eksportin e KEK-ut.
- Pjesa IV, Aplikimi Tarifor për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, lidhur me tarifën e SHSSH-së sipas nivelit të tensionit.

KEK-u ka shpenzuar një kohë të konsiderueshme për të kuptuar Rregullat e reja të Çmimeve që janë miratuar nga ZRRë-ja në nëntor të vitit 2011 dhe i ka aplikuar ato për përgatitjen e tërë aplikimit. Siç është dokumentuar në aplikim, Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) që kanë të bëjnë me konsumatorët e rregulluar në pajtueshmëri me këto rregulla janë 239 milion €. Të hyrat që priten në vitin 2012 bazuar në tarifën aktuale do të jenë 194 milion €, duke rezultuar në një rritje të tarifës së propozuar prej 45 milion € ose 23%.

Kosovo Energy Corporation J.S.C is a company incorporated under the laws of Republic of Kosovo
Registered number: 70325399
Registered office: No. 36 Mother Theresa Street, Pristina, 10000, Republic of Kosovo

g

Rritja tarifore rezultuese prej 45 milion Euro është pothuaj plotësisht rezultat i këtyre 2 faktorëve në vijim:

- 1. Përfshirja e aseteve të para vitit 2006** për mbulimin e kostos, në pajtueshmëri me rregullat e reja të çmimeve, të cilat i përkrah KEK-u. Rritja e çmimeve për shkak të përfshirjes së këtyre aseteve në përcaktimin e zhvlerësimit dhe kthimit është përafërsisht rreth 25 milion €. Për shumë vite, Qeveria ka siguruar një subvencion për konsumatorët e energjisë elektrike, duke e parandaluar koston e këtyre aseteve nga përfshirja në tarifa. Duke pasur parasysh se Qeveria nuk mund të vazhdojë me subvencionimin e sektorit të energjisë elektrike, ZRrE-ja ka ndërmarrur hapa që t'i bëjë tarifën më kosto reflektive.
- 2. Kostoja e energjisë së importuar që nuk subvencionohet nga Qeveria.** Në vendimin për tarifa për vitin 2011, ZRrE-ja ka përfshirë 50 milion Euro të koston të importit të zvogëluar për vlerën prej 27 milion Euro të subvencionuar nga Qeveria. Në këtë aplikim tarifor, KEK ka përfshirë koston e importit në vlerë prej 57 milion Euro të zvogëluar për vlerën prej 13 milion Euro të subvencionuar nga Qeveria që është e përfshirë në Buxhetin e Qeverisë 2012. Përfundimi është se në vitin 2012, do të kemi një vlerë neto prej 44 milion Euro të përfshirë në tarifa për kosto të importit krahasuar me 23 milion Euro të vitit të kaluar, ku ndryshimi është 21 milion Euro (KEK-u ka shpenzuar në të vërtetë 54.7 milion € në vitin 2011). Është e qartë se ndikimi i dyanshëm i eliminimit të granteve për shpenzimet kapitale dhe zvogëlimi i konsiderueshëm i subvencionit për import të energjisë ka bartur barrën e përgjegjësisë së këtyre kostove te konsumatorët, fillimisht amvisëritë.

Në fakt, në këtë aplikim tarifor KEK-u ka përfshirë zvogëlimet të konsiderueshme të koston në shpenzimet e Operimit dhe Mirëmbajtjes bashkë me një zvogëlim të konsiderueshëm të humbjeve komerciale. Këto zvogëlimet të koston janë bartur te konsumatorët në formën e kostove më të ulëta në HLM. Edhe pse KEK-u ka pasur borxhe të këqija prej 10% në vitin 2011 (një përqindje më e ulët se sa në vitet e mëparshme), ne po kërkojmë vetëm 5% në vitin 2012. Po ashtu, gjatë vitit 2012, KEK-u ka përfshirë një numër kredish për konsumatorët, përfshirë shumën e plotë prej 11 milion € të Llogarisë Balancuese të Tarifave, e identifikuar në rishikimin tarifor të vitit 2011 dhe zvogëlimet në HLM për vitin 2012, në sajë të mosshpenzimit të buxhetit të plotë kapital në vitin 2011. Është e qartë se KEK-u ka bërë çdo përpjekje për të zvogëluar koston që duhet t'i paguajnë konsumatorët.

KEK-u e kupton ZRrE-ja mund ta ketë të vështirë që ta pranojë në aspektin social rritjen e tarifave për 23% në përgjithësi dhe tarifave të amvisërisë për një përqindje më të madhe. Në rast se rritja totale nuk mund të përfshihet në tarifën me pakicë, KEK-u propozon që ZRrE-ja të përdor një mekanizëm “zbutës” transparent për të parandaluar një rritje të madhe në çmime. Një koncept zbutës përfshihet në rregullat e reja të çmimeve, megjithatë metoda e përdorur për zbutje në vendet shumë të zhvilluara nuk është e përshtatshme në Kosovë, kur dihet se çmimet janë ulta. KEK-u propozon që zbutja të arrihet duke bërë që secili i licencuar të “shtyjë afatin” e pjesës së Të Hyrave të tyre të Lejuara nga vitit 2012 për në vitet e ardhshme, një propozim që nuk duhet të shihet si fakt përsëritës për rishikimet e ardhshme tarifore. Shuma e shtyrë do të shtohet automatikisht në HLM të vitit 2014 dhe 2015 bashkë me koston e huamarrjes afatshkurtë. Shumat e shtyra të propozuara për Gjeneratorin Publik, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesin Publik janë gjithsej 20 milion €. Përveç shtyrjes së koston, ZRrE-ja mund të marrë në konsiderim një zvogëlim shtesë në humbjet komerciale (nga 15.6% në 15%) gjithë që do të lejonte energji shtesë për shitjet e amvisërisë. Këto përshtatje do të zvogëlonin rritjen tarifore deri në 12%.

KEK-u është në dijeni se edhe rritja prej 12% mund të paraqesë një problem social dhe rritja njëshifrore e përqindjes, si 9%, mund të jetë kufiri më i lartë. Në atë rast, alternativa e vetme e mundshme është që Qeveria të subvencionojë 7 milion € për qëllime specifike për subvencionimin e konsumatorëve të amvisërisë. Në fakt, konsumatorët e amvisërisë janë çështja kryesore në këtë rishikim tarifor. Amvisëritë shpenzojnë 56% të të gjithë energjisë me pakicë dhe ende paguajnë vetëm 65% të koston që u shërbehet atyre. Kjo është përkundër faktit se i tërë subvencioni i Qeverisë për energjinë e importuar (13 milion €) është alokuar për ta. Ata ende kanë mungesë prej 52 milion € për të mbuluar koston e tyre. Kjo është rezultat i veprimeve të Qeverisë gjatë disa viteve, e cila i ka mbajtur çmimet e amvisërisë artificialisht të ulëta. Kosova është angazhuar që të ndjekë Udhëzimet e Bashkimit Evropian në sektorin e energjisë elektrike dhe ato kërkojnë që subvencioni i tarifave të amvisërisë të hiqet nga kategoritë tjera të konsumatorëve deri në fund të vitit 2014. Ato udhëzime janë përfshirë në Ligjet e reja të Energjisë dhe në Rregullat e reja të Çmimeve të ZRrE-së. KEK-u është mbështetës i përpjekjeve për bërjen e tarifave më kosto reflektive dhe është duke u përpjekur që ta lehtësojë barrën për amvisëritë kurdo që është e mundshme.

Çështja e rritjes së tarifave nuk do të zgjidhet në vitin 2012 dhe rritja e tarifave do të jetë e nevojshme për çdo vit në të ardhmen bazuar në nivelet e kapaciteteve aktuale. Nëse Qeveria dëshiron që t'i mbajë tarifat me pakicë të ulëta, veçanërisht amvisëritë, huatë për miniera dhe gjenerim mund të transformoheshin në grante. Kjo do të rezultojë në një zvogëlim të konsiderueshëm në HLM për çdo vit në të ardhmen, meqë metodologjia tarifore thekson se asetete e financuara nga grantet nuk përfshihen në llogaritjen e kthimit.

KEK-u ka rritur kapacitetet e tij gjeneruese duke riaktivizuar njësinë A5 (150 MW) në vitin 2008 dhe ka gjeneruar rreth 20% më shumë energji në vitin 2011 se sa që ka gjeneruar në vitin 2007 si dhe ka importuar 45% më shumë energji elektrike gjatë periudhës së njëjtë. Prej vitit 2007 deri në vitin 2011, megjithatë, kërkesa e konsumatorëve është rritur më shumë se 23% dhe rritja e vazhdueshme nuk mund të shërbehet pa kapacitete shtesë ose një rritje të theksuar të importit. Duke ditur shumat që KEK-u shpenzon në import të energjisë për çdo vit, KEK-u dhe Kosova duhet që menjëherë të implementojnë një plan për rritjen e kapacitetit gjenerues vendor, si riaktivizimi i bllokut të Kosovës A2. Ai opsion është mënyra më e shpejtë për rritjen e furnizimit meqë gjenerimi i ri nuk pritet të jetë në dispozicion deri në fund të kësaj dekade. Me rritjen e furnizimit vendor, nevoja për import do të zvogëlohet dukshëm, duke përmirësuar kështu Sigurinë e Furnizimit.

Ju lutem, mos hezitoni të na kontaktoni në rast se kërkonin ndonjë qartësim ose informatë shtesë lidhur me Aplikimin.

Sinqerisht,


Arben Gjakaj
Drejtor Menaxhues i KEK Sh.a.



Kopje për:

Përparim Kabashi – Anëtar Bordi
Blerim Koci - Anëtar Bordi
Enver Halimi – Anëtar Bordi



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

To: Dr. Ali Hamiti
Head of Energy Regulatory
Office
1
Hamdi Mramori, Prishtina
10000

KEK Ref:

Your Ref:
Dated: 13.01.2012

**METHOD OF
DELIVERY: COURIER and
EMAIL**

SUBJECT: 2012 Tariff Application KEK J.S.C. – Submission of Part V

Dear Professor Hamiti,

Attached is the fifth and final part of KEK's tariff application for the year 2012. It is the application for the Public Electricity Supplier (PES) which documents and contains recommendations for (1) the costs of the Public Supplier, (2) the determination of the cost of all licensees to be included in regulated retail tariffs, (3) the methodology for determining the costs to serve the various customer classes to determine cost reflective tariffs, and (4) the manner in which the increase is reflected in the tariffs.

This part utilizes the information from Parts I through IV that were recently submitted to ERO:

- Part I, Baseline Information for all Licensees, which documented the Regulatory Asset Base and Weighted Average Cost of Capital
- Part II, Regulated Generator Tariff Application, concerning the costs of Kosovo A and B and the mine
- Part III, Wholesale Electricity Price, concerning the Wholesale Energy price, including KEK generation, cost of imports, purchases from other domestic generators, and exports.
- Part IV, Distribution Use of System Tariff Application, concerning the DUOS tariffs by voltage level.

KEK devoted significant time to understand the new Pricing Rules issued by ERO in November 2011 and applied them to develop the entire application. As documented in the application, the Maximum Allowed Revenues (MAR) related to regulated customers in accordance with those rules are €239 million. The revenue expected in 2012 based on current tariffs is €194 million, resulting in a proposed tariff increase of €45 million or 23%.

Kosovo Energy Corporation J.S.C is a company incorporated under the laws of Republic of Kosovo
Registered number: 70325399
Registered office: No. 36 Mother Theresa Street, Pristina, 10000, Republic of Kosovo

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
I Nr. 461 Dt. 13/01/2012
PRISHTINE

Arben Gjukaj
Managing Director KEK J.S.C

Elektrokosova Building
Bulevard Bill Clinton
Prishtina 10000,
Republic of Kosovo
www.kek-energy.com

9

The resulting €45 million tariff increase is almost entirely the result of two items:

1. **The inclusion of the pre 2006 assets** for cost recovery in accordance with the new pricing rules, which KEK supports. The increase in prices due to the inclusion of these assets in the determination of depreciation and return is approximately €25 million. For many years the Government provided a subsidy to electricity consumers by preventing the cost of those assets from being included in tariffs. Given that the Government cannot continue to subsidize the electricity sector, ERO took the steps to make tariffs more cost reflective.
2. **The cost of imported power not subsidized by the Government.** In its 2011 tariff decision, ERO included €50 million of import costs offset by a subsidy of €27 million. In this tariff application, KEK is proposing an import cost of €57 million offset by the €13 million subsidy contained in the 2012 KCB. The result is that in 2012 there are a net of €44 million of import costs in tariffs as compared to €23 million last year, a difference of €21 million (KEK actually spent €54.7 million in 2011). It is apparent that the dual impact of eliminating grants for capital expenditures and significantly reducing the import power subsidy has shifted the responsibility for those costs to customers, primarily households.

In fact, KEK has incorporated significant cost savings in Operation and Maintenance costs in this tariff application along with a significant reduction in commercial losses. These cost savings are passed through to customers in the form of lower costs in the MAR. Although KEK experienced bad debts of 10% in 2011 (which are lower than prior years) we are only requesting 5% in 2012. Also, KEK has included a number of credits to customers in 2012 including the entire €11 million amount of the Tariff Balancing Account identified in the 2011 tariff review and reductions in 2012 MAR due to not spending the entire capital budget in 2011. It is clear that KEK has made every effort to minimize the costs that customers must pay.

KEK recognizes that ERO may find it socially unacceptable to increase tariffs by 23% overall and household tariffs by an even greater percent. In the event that the total increase cannot be included in retail tariffs, KEK proposes that ERO utilize a very transparent "Smoothing" mechanism to prevent a major spike in prices. A smoothing concept is included in the new pricing rules, however, the method used to smooth in highly developed countries is not appropriate in Kosovo where prices are so distorted. KEK proposes that smoothing be accomplished by having each licensee "Defer" a portion of its Allowed Return from 2012 to future years, a proposal that should not be viewed as setting a precedent for future tariff reviews. The deferred amount would be automatically added to the MAR in 2014 and 2015 along with the cost of short term borrowing. The proposed deferral amounts for the Public Generator, Distribution System Operator, and Public Supplier total €20 million. In addition to the cost deferral, ERO may consider an additional reduction in commercial losses (from 15.6% to 15%) which would allow additional energy for household sales. Those adjustments would reduce the tariff increase to 12%.

KEK is aware that even the 12% increase may present a social problem and a single digit percent increase such as 9% may be the upper limit. In that event, the only feasible option is for the Government to provide a subsidy of €7 million for the specific purpose of subsidizing household consumers. In fact, the household customers are a very key issue in this tariff review. Households consume 56% of all retail energy yet they pay only 65% of the cost to serve them. This is despite the fact that the entire Government subsidy for imported power



(€13 million) was allocated to them. They still are €52 million short of covering their cost. This is the result of Government actions over many years that held household prices artificially low. Kosovo is committed to following European Union Guidelines in the electricity sector and those require that the subsidy of household tariffs by other customer classes be removed by the end of 2014. Those guidelines were incorporated in the new Energy Laws and in the new ERO Pricing Rules. KEK is supportive of the efforts to make tariffs more cost reflective and is attempting to ease the burden on households whenever possible.

The issue of tariff increases is not going to be resolved in 2012 and tariff increases will be needed each year for the foreseeable future based on current capacity levels. If the Government wants to keep retail tariffs low, especially for households, the loans for mining and generation could be converted to grants. That will result in a significant reduction in MAR each year going forward since the tariff methodology states that grant funded assets are not included in the return calculation.

KEK has increased its generation capacity by reactivating A5 (150MW) in 2008 and has produced about 20% more energy in 2011 than it produced in 2007 and imported 45% more electricity during the same period. From 2007 to 2011, however, the customer demand increased by over 23% and continued growth cannot be served without additional capacity or significant increase in import. Given the amounts that KEK spends on imported power each year, KEK and Kosovo need to immediately implement a plan to increase domestic generating capacity such as reactivating the Kosovo A2 unit. That option is the fastest way to increase supply since new generation is not expected to be available until late in this decade. By increasing domestic supply, the need for import will be significantly diminished, thereby improving Security of Supply.

Please feel free to call on us, should you require any clarification or additional information regarding the Application...

Yours sincerely


Arben Gjakaj
Managing Director, KEK J.S.C



Copy to:

Përparim Kabashi - Board Member
Blerim Koci - Board Member
Enver Halimi – Board Member